



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

**KEC**

**Kodi: 029**

## **TRANSPARENCA, ETIKA DHE MASAT ANTI-KORRUPSION NË ARSIM**

### Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të njohin përkufizimet e praktikave korruptive në arsim, sjelljet jo-etike të personelit edukativo- arsimor, si dhe hulumtimet e ndryshme që realizohen për të vlerësuar shkallën e korrupsionit në një vend (PETS, QSDS).
- Të identifikojnë format e ndryshme të paraqitjes së korrupsionit në arsim, si dhe strategjitë dhe masat gjithëpërfshirëse për luftimin e tij.
- Të njohin konventat e ndryshme ndërkombëtare për luftimin e korrupsionit.
- Të reflektojnë për lidhjet që ekzistojnë në mes të korrupsionit, varfërisë, si dhe krijimit dhe zhvillimit të demokracisë.
- Të bëhen burim përvoja dhe njohurish për të tjerët duke shpërnda informacion në vendin e tyre të punës për të sensibilizuar kolegët që të mos bien pre e dukurive korruptive.
- Të inicojnë projekte, të cilat do t'i kontribuonin parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

### Përmbajtja

1. Etika dhe korrupsioni në arsim. Përkufizimi dhe format e paraqitjes së korrupsionit në arsim. Praktika të korrupsionit në arsim. Vlerësimi i shkallës së korrupsionit (CPI dhe GCB). Strategjitë për luftimin e korrupsionit. Masat për luftimin e korrupsionit në sektorin e financimit. Strategjia shumë - dimensionale për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në financim. Anketat hulumtuese (PETS). Masat për luftimin e korrupsionit në sektorin e menaxhimit të mësimdhënësve. Vlerësimi i praktikave të shtrembëruara në menaxhimin dhe sjelljen e mësimdhënësve (QSDS, Auditimi). Përpilimi i kodeve të mirësjelljes. Masat për luftimin e korrupsionit në sektorin e prokurimit publik. Përkufizimi i paktit integruar. Monitorimi me pjesëmarrje. Arsimi i lartë dhe korrupsioni. Monitorimi i mësimin privat në bllokun e ish shteteve socialiste.

Integrimi i idesë së luftës kundër korrupsionit në njësitë mësimore të disa lëndëve shoqërore.

### Grupi i synuar

Nga ky program mund të përfitojnë zyrtarë të institucioneve qendrore dhe lokale, anëtarë të OJQ-ve, administratorët e shkollave, hartuesit e kurrikulave dhe të teksteve shkollore, zyrtarët e arsimit, mësimdhënësit, si dhe të gjithë qytetarët, të cilët synojnë të kontribuojnë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

### Forma e organizimit/ Kohëzgjatja

Programi organizohet në formë të seminarit 3 ditore. Programi ka gjithsej **20 orë**.

### Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja me rregull në seminar.